

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"JUBICA", SHPK

Themeluesit e SHPK janë:

Shaban Bitri, i biri i Qazimit, lindur ne 1949 dhe banues ne Shkoder, lagja "Manush Alimani", Rr"Alqi Kondi", Pall 1021, me Nr pasaporte

Gjin Bisha, i biri i Markut, lindur ne 1942, banues ne lagjen "Tom Kola", Rr"Marin Barleti", Pall 3, Shkoder, me Nr pasaporte

Neni 1

Themeluesit do te ndertojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te cilen do ta quajne "JUBICA"

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Shkoder, lagja "Tom Kola", Rr "Marin Barleti", Pall Nr 3.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve mund te hapen seli sekondare, filiale apo forma te tjera shoqerish, ashtu sikunder do ta shohe te nevojshme SHOQERIA, brenda dhe jashte Shqiperise.


Neni 3

Kohezgjatja e SHOQERISEdo te jete deri ne fundin e vitit 2004, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne statut.

Neni 4

SHOQERIA ka si objekt te veprimtarise se saj:

- sipermarje ndertimi te objekteve te ndryshme
- prodhime te materialeve te ndertimit per nevojat e veta dhe per te tretet
- tregetim te materialeve te ndryshme te ndertimit
- perfaqesim te firmave te huaja per eksport-import te mallrave sipas prokures qe do te japin te interesuarit si dhe





ndermjetesine per tregetim te mallrave jashte shtetit

- importimin dhe eksportimin e te gjitha llojeve te mallrave, pajisjeve dhe impjanteve elektrike dhe elektronike te karakterit publik industrial dhe detar, ne teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

-te importoje dhe eksportoje, bleje, shese, shkembeje, te marre dhe te jape me qira, te trajtoje, ndryshoje apo perpunoje sipas interesit te saj objekte, mallra, produkte dhe nenprodukte te cdo lloji, qe lidhen direkt me objektin e veprimtarise se saj ose edhe indirekt, por qe kane interes dhe leverdi per te.

-te kryeje te gjitha operacionet bankare si depozitime, kreditime, likujdime te parave, ne kushtet e percaktuara nga legjislacioni shqipetar

-te realizoje kontrata, marreveshje, ortakeri, shogeri te perbashketa, apo forma te tjera te lejuara nga legjislacioni shqipetar, me persona fizike dhe juridike shqiptar ose te huaj, per te realizuar veprimtari te ndryshme qe jane te nevojshme dhe me interes per SHOQERINE.

Neni 5

Kapitali themeltar i SHOQERISE do te jete 1.000.000(njemilion) leke me kontributet e meposhtme:


Shaban Bitri me kuote pjesmarrese prej 500.000(pesqindmije) leke.

Gjin Bisha me kuote pjesmarrese prej 500.000(pesqindmije) leke.

Neni 6

Kapitali themeltar eshte depozituar prej tij ne Banken e Shqiperise, me nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim e siper.

Shuma e depozituar vertetohet me ane te nje certifikate te leshuar nga ajo Banke, ne te cilen shenohet shuma e kapitalit te




derdhur.

Neni 7

SHOQERIA do te rregullohet, pervec ketij akti themelues edhe me norma te percaktuara ne Statutin e saj, i cili do te nenshkruhet nga ortaket dhe si i tille do te miratohet ne Gjykatën e Rrethit Tirane, ne ditën kur do te legalizohet si person juridik ne shqiperi.

THEMELUESIT

Shaban Bitri



REPUBLIKA E SHQIPERISE


MINISTRIA E DREJTESISE

NOTERIA

Nr 5/60 Rep

Nr 4/60 Kol

Gjin Bisha



Tirane, me 16.1.1994

VERTETIM

Sot me datën 16.1. 1994, para meje noteres, u paraqiten personalisht z. Shaban Bitri e Gjin Bisha, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda nga leternjoftimet qe mbanin me vehte, te cilet me deklaruan se sa me siper eshte shkruar me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, nenshkruar rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE



Mimozë Selç
22.11.94